

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË (HUAMARRËSI), OPERATORIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE (OSHEE), SH.A., (AGJENCIA ZBATUESE E PROJEKTIT) DHE KFW, FRANKFURT AM MAIN (KFW), PËR PROGRAMIN E INVESTIMEVE PËR SHPËRNDARJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE I”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektligj synon ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (huamarrësi), Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), sh.a. (agjencia e zbatuese e projektit) dhe KfW, Frankfurt am Main (KfW), për financimin e programit të investimeve në shpërndarjen e energjisë elektrike I.

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është dhënia e një huaje nga qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, e cila i akordon fondet nëpërmjet KfW-së, për Republikën e Shqipërisë (huamarrësi), në shumën prej 30 000 000 (tridhjetë milionë) eurosh, hua e cila do të përdoret për financimin e projektit “Për programin e investimeve në shpërndarjen e energjisë elektrike I”.

Nga pikëpamja strategjike, programi do të ndikojë në përmirësimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, reduktimin e humbjeve të energjisë elektrike në rrjetin e shpërndarjes, si dhe rritjen e cilësisë dhe të sigurisë së furnizimit me energji elektrike për klientët në Shqipëri.

Gjithashtu, qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë do t’i akordojë Republikës së Shqipërisë një grant në vlerën prej 2 000 000 (dy milionë) eurosh, që do të financojë masat e nevojshme shoqëruese në kuadër të këtij programi.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj është në përputhje të plotë me politikat e Këshillit të Ministrave për mbështetjen e sektorit elektroenergjetik, duke synuar përmirësimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, reduktimin e humbjeve të energjisë

elektrike në rrjetin e shpërndarjes, si dhe rritjen e cilësisë dhe të sigurisë së furnizimit me energji elektrike për klientët në Shqipëri.

Për sa i përket planifikimit në projektaktet e vitit 2019, sqarojmë se ky projektakt nuk është planifikuar në programin analitik të akteve për vitin 2019 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, por, nisur nga rëndësia që paraqet ky financim për sektorin elektroenergjetik, e konsiderojmë të domosdoshëm miratimin sa më shpejt të tij.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektligji do t'i mundësojë Republikës së Shqipërisë marrjen e një huaje me kushte të favorshme nga KfW-ja për projektin "Për programin e investimeve në shpërndarjen e energjisë elektrike I", në vlerën prej 30 000 000 (tridhjetë milionë) eurosh.

Konkretisht, me anë të fondeve që do të sigurohen nga kjo marrëveshje, do të realizohen komponentët e mëposhtëm:

- Komponenti i parë do të realizojë dhe do të krijojë një sistem kontrolli mbikëqyrës dhe të përpunimit të të dhënave (SCADA), do të krijojë një sistem menaxhimi të shpërndarjes (DMS), sistem të shpërndarjes së ngarkesës (LDS), një qendër të kontrollit të shpërndarjes (DCC), dhe sisteme të tjera të integruara të teknologjisë së informacionit (IT).
- Komponenti i dytë do të përfshijë rehabilitimin dhe/ose ndërtimin e nënstacioneve të përzgjedhura 110 kV/20 kV, duke përfshirë kapacitetin e transmetimit në 2x40 MVA në nënstacionet e mbingarkuara, si dhe zgjerimin e voltazhit të mesëm të nënstacioneve ekzistuese.
- Komponenti i tretë do të përfshijë përshtatjen e rrjetit me voltazh të mesëm në nivelin 20 kV në zonat e përzgjedhura.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji i propozuar është në përputhje me nenet 78,83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës.

Në zbatim të shkronjës "ç", të pikës 1, të nenit 121, të Kushtetutës, marrëveshja do të hyjë në fuqi pas ratifikimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektakt nuk përafron me ndonjë *acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji parashikon ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (huamarrësi), Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë (OSHEE), sh.a. (agjencia zbatuese e projektit) dhe KfW, Frankfurt am Main (KfW), për financimin e programit të investimeve në shpërndarjen e energjisë elektrike I”.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e projektligjit ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe OSHEE, sh.a., Projekti do të zbatohet nga OSHEE, sh.a.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji i propozuar është hartuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, asistuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe OSHEE, sh.a.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Kostoja e programit është parashikuar në vlerën prej 32 000 000 eurosh (duke përfshirë masat shoqëruese dhe duke përjashtuar këtu TVSH-në), kosto e cila do të financohet nëpërmjet marrëveshjes së huas në fjalë prej 30 000 000 eurosh dhe grantit prej 2 000 000 eurosh që do të akordohet nga qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë dhe për të cilën do të lidhet një marrëveshje e veçantë financimi me KfW-në. OSHEE, sh.a., do të mbulojë nga buxheti i saj kostot për mbulimin e TVSH-së dhe kosto të tjera lokale në kuadër të projektit.

Huaja që do të akordohet nga KfW-ja ka termat e mëposhtëm:

- Shuma e financimit: 30 000 000 euro;
- Interesi: normë fikse vjetore, e cila do të përcaktohet një ditë pas njoftimit ndaj KfW-së se marrëveshja është bërë efektive;

- Tarifa e angazhimit: 0.25% vjetor mbi shumën e padisbursuar të kredisë. Kjo tarifë do të fillojë të aplikohet 12 muaj pas nënshkrimit të marrëveshjes;
- Tarifa e menaxhimit: 1% mbi shumën e kredisë;
- Maturimi: 12 vjet, duke përfshirë periudhën prej 4 vjetësh pa pagesë principali.

Huaja që do të akordohet nëpërmjet marrëveshjes në fjalë, do t'i nënhuazohet Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike me të njëjtat terma dhe kushte financiare si huaja e akorduar nga KfW-ja, me anë të kësaj marrëveshjeje.

Norma e interesit të huas nuk përcaktohet në marrëveshje, por është dakordësuar në marrëveshje se kjo normë do të përcaktohet nga KfW-ja dy ditë pune nga marrja e njoftimit tonë se janë përmbushur kushtet e bërjes efektive të marrëveshjes së huas. Ky është një kusht i vendosur nga KfW-ja, pasi, derisa kredia të bëhet efektive dhe të konsiderohet kredi e angazhuar për vendin tonë, nuk ka një bazë ligjore për KfW-në për të përcaktuar normën e interesit.

KfW-ja është një institucion i vlerësuar maksimalisht (AAA) nga agjencitë ndërkombëtare të vlerësimit të riskut dhe, si e tillë, ajo mundëson refinancimin e kredive me kushte shumë të favorshme në tregun e kapitaleve.

Në marrëveshjen qeveritare të nënshkruar ndërmjet qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (ku dy qeveritë bien dakord për bashkëpunimin financiar për programin në fjalë), ndër të tjera, parashikohet se qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga *Kreditanstalt für Wiederaufbau* (KfW) një kredi të butë në vlerë të përgjithshme deri në 30 000 000 euro, e cila jepet në kuadër të bashkëpunimit publik për zhvillim për zbatimin e projektit “Programi i investimeve në shpërndarjen e energjisë elektrike I”. Në këto kushte, mundësohet që termat e favorshëm të përfitimit të fondeve nga KfW-ja (mbështetur në instrumentin e subvencionimit të interesit nga qeveria gjermane, si dhe fondeve të vëna në dispozicion nga kjo e fundit për projektin në fjalë) t'i transmetohen vendit tonë.

Gjithashtu, lidhur me kreditë për zhvillim që akordon KfW-ja, raporton pranë OECD-së, ku kreditë duhet t'i përmbahen një sërë kriteresh për t'u konsideruar si kredi ndihmë për zhvillim (ODA). Një nga kriteret më të rëndësishme është elementi grant i këtyre kredive (*grant element*), ku ky element duhet të jetë së paku në nivelin prej 10% për vende me të ardhura mbi mesataren (siç është klasifikuar vendi ynë nga Banka Botërore).

Nga pikpamja historike e bashkëpunimit me KfW-në si një partner i besueshëm zhvillimi, kryesisht kreditë e akorduara nga kjo e fundit në dhjetë vitet e fundit

kanë pasur norma interesi të fiksuara në nivelin prej rreth 1-2%, ku mënyra e përcaktimit të normës së interesit ka qenë po njëllë si kredia e propozuar, pra, pas momentit të bërjes efektive të huas). Këto lloj normash, krahasuar me instrumentin më afatgjatë të huas që ka vendi ynë në tregun ndërkombëtar (*Eurobondi 2018*), janë rreth tri herë më të ulëta, kjo duke marrë parasysh për më tepër që edhe afati i maturimit të huas së KfW-së është më i gjatë sesa afati i *Eurobondi*-t.

Edhe për huan që synohet të përfitohet me anë të kësaj marrëveshjeje, parashikohet që norma të jetë poshtë nivelit prej 2%. Konkretisht, në ditën e negociimit të marrëveshjes së huas, norma indikative e interesit ishte 1.3%. KfW-ja është e gatshme të sigurojë informacion mbi normën e interesit të përlogaritur në çdo kohë (me një kërkesë paraprake drejtuar dy ditë para) deri në momentin e hyrjes në fuqi të marrëveshjes kur njoftohet norma e interesit që do të aplikohet për huan në fjalë.

KËSHILLI I MINISTRAVE